ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1144

Tiranë, 12 Maj 1939

Fort i nderuar im Ungj,

Mora letren t'uaj me anen e z. V. Turtulli dhe e kendova me kenaqesi. U-gezova veçanerisht per sa mesova mbi marredheniet e mira qe kini filluar me autoritetet e personalitetet Italiane, te cilet po provojne se dine te çmojne njerezit me karakter dhe jo hipokritet. Keto informata m'i vertetoi edhe me goje z. Turtulli si edhe i dashuri prof. Sotir Kozmo, me te cilin bisedova me gjate.

Sa per te ketushmit qe punonin djallezisht kunder juve, ate i thashe edhe une Shk. T. Ministrit Ypi, qe Dhespoti yne nuk ka bere gje kunder tyre, veç se detyren, as qe ka dashur te hape zjarr, po ata kane vepruar per interesa personale dhe ligesi. Neise, duket se e pushuan havazin...

Per pllaken e fotografis i thashe z. Sherko po ay, mjerisht, thote qe s'ka pllake tjater, veç se kopjet e fotografis, nga te cilat kini marre. Vajta edhe ne fotografi, edhe ay thote qe s'ka mbajtur pllake, dy qe qiti i dha; duket se njeren e do t'a mbaje z. Sherko, me mos e ka humbur ne Zyre; do t'ia kujtonj edhe nje here. Me te vertet pa-fat ka qene ajo fotografi. Jazek! Se ish nje kryevepre artistike dhe kush e di ne ç'duar ra, se pallati, siç e dini, u-plaçkit dhe u-be si Sόδομα και Γόμορρα (pa u-djegur vetem); veç se ne e kane marre me vehte. Ne keto koherat e

fundit kam marre dy letra nga Kosta.
Mejton te vinje dhe i dhashe nje pergjigje.
Adresa e Violetes esht kejo:

Violeta Xhaçka, Οἰκοτροφεῖον Χ. Ε. Ν.
Ὁδὸς 4ης Αὐγούστου 11
Θεσ/νίκην

Ju uroj shendoshje te mira. Nuk di se kur mejtoni te shkoni dhe sa do te rini, se tashi esht edhe koha qe ~~ta~~baron shkolla dhe s'di si te bej per t'a spelle ketu çupen; apo t'a leme ~~ta~~ vezoje andej?.

Ime-shoqe dhe femija ~~ju~~ puthin doren.
Dhiakos te fala.

Me dashuri e nderim
Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ